

INSTITUTI PEDAGOGJIK I KOSOVËS

FTESË

Për pjesëmarrje në Konferencën Ndërkombëtare Shkencore:

DREJT ASPEKTEVE PEDAGOGJIKE TË KOMPETENCËS DIGJITALE

Të nderuar studiues, hulumtues dhe profesionistë, mësimdhënës dhe studentë nga fusha e arsimit parauniversitar, çështja e aftësisë (kompetencës) digjitale të shoqërisë është bërë domosdoshmëri e kohës.

Zhvillimet globale në teknologji e kanë bërë thuajse të pamundur realizimin e punëve dhe detyrave të jetës së përditshme, qoftë në mësimdhënie, në nxënie e gjetiu, pa një përgatitje të mirëfilltë teorike dhe praktike nga fusha e teknologjisë.

Përpjekjet institucionale për të përcjellë kahet e zhvillimit të teknologjisë, si dhe investimet në këtë sektor, kanë dhënë rezultate të dukshme, por nuk dihet ndikimi i këtyre përpjekjeve dhe investimeve në cilësinë e përgatitjes së mësimdhënësve, nxënësve dhe stafit tjetër, në zbatimin e këtyre investimeve në praktikën mësimore/shkollë. Këtë synon ta bëjë IPK-ja nëpërmjet kësaj konference ndërkombëtare.

Qëllimi i Konferencës

Konferenca, nëpërmjet hulumtimit, synon të identifikojë nivelin dhe cilësinë e përgatitjes/aftësisë të mësimdhënësve, nxënësve dhe stafit tjetër shkollor, për zbatimin e teknologjisë në mësimdhënie dhe nxënie, si dhe në aktivitetet e tjera punuese. Gjithashtu, synim i konferencës është vlerësimi i shkallës së adresimit të komponentit digjital në Kurrikulë, si dhe në tekste shkollore, si burim bazë për aftësim digjital të tyre.

Pjesëmarrja në konferencë do të jetë e hapur për të gjithë të interesuarit dhe ekspertët e fushës së aftësisë digjitale në arsimin parauniversitar. Pasja e një pasqyre sa më reale për këto aspekte do ishte një vlerë e shtuar për vendimmarrësit, si dhe për kahet e zhvillimit të sistemit arsimor cilësor.

Prandaj, ju ftojme dhe ju inkurajojmë që idetë, punimet dhe trajtesat tuaja për pjesëmarrje dhe prezantim në konferencë, t'i dërgoni sipas afatit të paraparë.

Punimet t'i dërgoni sipas kriterëve dhe afateve të dhëna më poshtë.

Çka mund të dërgohet për prezantim?

Të gjitha punimet tuaja: hulumtime, trajtesa, analiza krahasuese, hulumtime në veprim, të cilat trajtojnë aspekte të veçanta nga **tema bosht**, mund të dërgohen për pjesëmarrje dhe prezantim në konferencë.

FTESË PËR KONFERENCËN E IV-TË 2023

Dërgimi i abstraktit dhe punimit

Dërgimi i abstraktit dhe/punimit, pyetjeve dhe kërkesave, duhet të bëhet në këtë e-mail:
kpi.conference.info@gmail.com

Abstraktet/punimet do të shqyrtohen nga Këshilli Redaktues i Konferencës.

Afatet për dërgimin e abstraktit

• Abstrakti duhet të dërgohet deri më:	<u>10 mars 2023</u>
• Njoftimi për vlerësimin deri më:	<u>03 prill 2023</u>
• Afati për plotësimin e dhe ridërgimin e abstraktit:	<u>03 maj 2023</u>

- Abstrakti përfundimtar duhet të dërgohet në dy gjuhë: shqip dhe anglisht.
- Dërgimi i prezantimit për konferencë bëhet jo më vonë se një javë para konferencës.
- Format i prezantimit do t'u dërgohet pjesëmarrësve që u janë pranuar abstraktet.
- Lidhur me formatin dhe kriteret për botimin e punimit, do të informoheni me kohë.
- Koha e organizimit të konferencës: 31.10 - 01.11. 2023 (tentative).
- Për datën e saktë, agjendën dhe vendin e konferencës, do të informoheni me kohë.

Vëmendje: Ju lutemi t'i respektoni afatet e përcaktuara! Abstraktet që dërgohen pas afateve të përcaktuara nuk do të shqyrtohen.

Sesionet tematike të konferencës:

- Kompetenca digjitale e mësimit në mësime
- Kompetenca digjitale e nxënësve
- Kompetenca digjitale e stafit tjetër të shkollës
- Adresimi i kompetencës digjitale në KK dhe programe mësimore
- Çështje të përgatitjes së mësimit në mësime para shërbimit për zbatimin e KD.
- Trendët/kahet aktuale në zhvillimin e kompetencës digjitale në arsim.

Kriteret për abstraktet

Titulli i punimit: Titulli duhet ta prezantojë përmbajtjen e punimit, i cili nuk duhet të ketë më shumë se 25 fjalë.

Abstrakti: 250-300 fjalë. Deri 7 fjalë çelës.

Emrin, mbiemrin e autorit, emrin e institucionit ku punon.
Stili i shkrimit kërkohet vetëm sipas APA-s, botimi i 7-të.
Stili i shkronjave Times New Roman 12, titulli 14.

FTESË PËR KONFERENCËN E IV-TË 2023

Abstrakti dërgohet përmes postës elektronike/e-mail-it: kpi.conference.info@gmail.com

Abstraktet vlerësohen nga Këshilli Redaktues i Konferencës. Secili pjesëmarrës do të informohet me rezultatin e vlerësimit. Të gjithë ata që marrin vlerësim pozitiv do të ftohen të prezantojnë punimin në konferencë. Pjesëmarrja në konferencë është e lirë për të gjithë të interesuarit e regjistruar në afatin e paraparë. Secili i interesuar **duhet** të regjistrohet!

Abstraktet e pranuar dhe të prezantuara në konferencë do të botohen në Librin e abstrakteve, ndërsa punimet e plota në Librin e Konferencës 2023.

Duke e vlerësuar kontributin tuaj në zhvillimin shkencor, ekonomik, kulturor dhe shoqëror, ju lusim që **Ftesën** për konferencën e këtij viti ta shpërndani te komuniteti studiues, brenda dhe jashtë Kosovës.

Lidhur me formën e organizimit të konferencës, online ose me pjesëmarrje fizike, do të njoftoheni së paku 10 ditë para datës së mbajtjes.

Ju njoftojmë se Instituti Pedagogjik i Kosovës nuk siguron akomodim apo transport për pjesëmarrësit në konferencë, vetëm nëse janë të ftuar të veçantë nga organizatori i konferencës.

Datë: 02.02.2023

Këshilli Redaktues i Konferencës

Ju mirëpresim!